

RILINDASI

E diel
31 maj 2015
Viti IV - Nr:73
E-mail: rilindasi@gmail.com
Kryeredaktore;
Admirina Peçi

Suplement i SHQIPTARJA.com

KALAJA E KANINËS

Misteri i kullës së sahatit, ja gjurmët e mbetura në dokumente

NGA DRITAN ÇOKU

Në Shqipërinë Jug-perëndimore një nga fortifikimet e rëndësishme mesjetare është edhe Kanina e ngritur në një kodër 379 m. të lartë. Ndonëse muret e qytetit të fortifikuar të Kaninës ndjekin trasenë e periudhës antike, formën dhe pamjen në gjendjen që trashëgojmë sot, ai e mori përgjatë mesjetës. [1] Në vitin 1530 kalaja rindërtohet nga sulltan Sulejmani, ndërsa ndërtimet e fundit të shek. XVII-XIX i përkasin përpjekjeve të feudaleve shqiptare të Vlorës për të rimëkëmbur këtë fortifikim. [2]

Për kalanë e Kaninës na informon udhëpërshkruesi osman Evlija Çelebi në shek. XVII duke përshkruar nga portat e kalasë, fortesën e brendshme, xhaminë e mbuluar me tjegulla që e cilëson



me një minare të bukur dhe pallatin e Gazi Sinan Pashës afër saj... [3] (fig.1)

Në fillim të shek.XIX, si Leake [4] më 9 dhjetor 1804 ashtu edhe Pouqueville [5] më 1807 e përshkruajnë kalimthi kalanë e Kaninës dhe fshatin me të njëjtin emër. Më 1812 kalaja ra në duart e Ali pashës. [6] Kalaja e Kaninës e lënë pas dore si fortifikim që nga viti 1832 iu nënshtrua shkatërrimeve të herëpashershme. [7] Në gjendje të mjerueshme e gjetën ushtarët turq në gusht të vitit 1848 kur erdhën për të shtruar kryengritjen kundër Tanzimatit. Këtë na e vërteton edhe kënga popullore: "Atje, në limën në Vlorë, tre karadhe e dy pampor, prunë nizam edhe tabor, zunë kalan që ish bërë horr!" [8] Më 21 tetor 1848 në kalanë e Kaninës ngjitet edhe artisti anglez Edëard Lear [9] ku realizon një vizatim në të cilin duket mjaft mirë kulla e sahatit....
vijon në faqen 18-19

Festivali Foklorik i Gjirokastrës, vlerat e nëpërkëmbura

Një vështrim kritik rreth disa dukurive që u vërejtën në festivalin më të rëndësishëm të muzikës folklorike shqiptare, mbajtur në Gjirokastrë nga 10-16 maj 2015...

NGA VLASH PRENDI

Më në fund edhe eventimi më i rëndësishëm folklorik mbarëkombëtarë përfundoi. Përfundoi aktiviteti më i madh që promovon ritmikisht në çdo 5-vjet kërkimet dhe vlerat e këngës dhe valles burimore mbarëkombëtare shqiptare, për të cilin pak u interesuam, pak kontribuam dhe akoma më pak punuam. Ishte një festival vlerash, gjetjesh, përsëritjesh, mungesash dhe prapaskenash, për të cilin organet përkatëse sidomos Ministria e Kulturës, apo Instituti i Antropologjisë duhej të ishin menduar më mirë. Mirë duheshin programuar edhe paraqitjet dhe komisionet përzgjedhëse në rrethe, pasi për të organizuar një festival si ky yni që e ka zanafillën që nga viti 1968. ...
faqe 22



Imzot Nikollë Kaçorri, 98 vjet nga ikja e atdhetarit dhe arkitektit të Pavarësisë

Është lënë gjithnjë në heshtje, me gjithësa ka qenë, për krahas Ismail Kemal Vlorës, edhe ndënkryetar i denjë i së parës qeverie shqiptare, i zgjedhur prej një atij Kuvendi Kombëtar që shpalli pavarësinë e Atdheut

NGA PJETER LOGORECI

faqe 20-21

Kristi Gjezi, fisniku i ri i violinës në skenat botërore

Fitues i katër çmimeve ndërkombëtare të fituara në Francë, Zvicër, Spanjë, Moskë. Gazeta "Le Marseillais", në nëntor 2013, cilësonte se ky violinist 23-vjeçar do ketë një të ardhme të ndritur

NGA INA KOSTURI

Violina si instrument studiohet në moshë fare të vogël. Krenohen muzikantët me koncertet e para në një garë shpejtësie, talenti e sfide me veprat, kompozitorët e rëndësishëm e më pas me studimet në Konservatorët e shkollat prestigjioze të artit. Debutojnë suksesshëm në skenë, përjetojnë emocionet e duartrokitje. E vetëm disa ndjekin ëndrrën e gjithë violinistëve të famshëm, lavdinë që japin në mënyrë speciale dhe të padiskutueshme konkurset e rëndësishme ndërkombëtare, udhërrëfyset e suksesit të instrumentistëve. Ata më të mirët, që përballojnë e nisin një karrierë ndërkombëtare marrin pjesë në këto eventime të botës muzikore, të njohura
faqe 23

IN | MEMORIAM

IMZOT *Nikollë* KAÇORRI

98 vjet nga ikja e atdhetarit dhe arkitektit të Pavarësisë

Është lënë gjithnji në heshtje, me gjithëse ka qenë përkrah Ismail Kemal Vlorës, edhe ndënkryetar i denjë i së parës qeveri shqiptare, i zgjedhur prej një atij Kuvendi Kombëtar qi shpalli pavarësinë e Atdheut



NGA PJETER LOGORECI

Në rastin e 98 vjetorit të vdekjes së kolosit atdhetar Imzot Nikollë Kaçorrit, arkitektit të pavarësisë së Shqipërisë dhe të krijimit të shtetit shqiptar, dëshiroj me këtë shkrim ti bëj atij një homazh, për kontributet e tij të pamohueshme që ka dhënë për të mirën e kombit shqiptar. Ndër shkrimet e tjera që kam bërë për Imzot Kaçorrin, kam sjellë dokumente dhe informacione të panjohura mbi ngjarjet e kompletet e autoriteteve turke për arrestimin e tij, pasi i shqetësonte aktiviteti i tij atdhetar në favor të organizimit të popullit në kryengritje për liri e pavarësi.

Në këtë shkrim, në kujtim të Imzot Kaçorrit, dëshiroj të sjell disa dokumente të panjohur, të cilët janë pjesë e dosjes PAVARSIA që gjendet në arkivën shtetërore të Vjenës. Informacione dhe telegrame të konsullatave austriake të Durrësit, Vlorës e Shkodrës që lidhen me situatën politike para dhe pas shpalljes së pavarësisë. Dokumente mbi krijimin e senatit të parë shqiptar, listat emrore të senatorve si dhe një përshkrim të shkurtër biografik për çdo njërin prej tyre. Është për tu shënuar fakti që kjo dosje është parë me dhjetra herë nga studiues apo historian të ndryshëm shqiptar nga të gjitha trevat tona, por dokumentet ku shkruhet për Imzot Kaçorrin kanë qenë "jashtë interesit" të tyre (e për rrjedhojë

të pabotuara), sikurse kanë qenë "jashtë interesit" për 94 vjet edhe varri dhe eshtrat e tij. Sic duket, kjo nga një ndikim i fortë komunist dhe antikristian i diktaturës, pasi Imzot Kaçorri shihej si prift katolik dhe ishte i padëshirueshëm për regjimin e Tiranës.

Sipas përjetimeve që pata personalisht më pas, në ditët e pluralizmit (gabimisht besova se erdh demokracia), sjellja ndaj këtij kolosi të lirisë dhe shqiptarisë ishte e njëjtë. Interesimi nga shteti postkomunist për këtë figurë vazhdonte të ishte i pakët. Qëndrimi i qeverisë dhe diplomacisë shqiptare në rastin e sjelljes së eshtrave, ishte i turpshëm dhe mospëfillës. Më parë nuk kisha dashur ta besoj, por shpesh më sillje në kokë pyetja...: ...përse në monumentin e pavarësisë në Vlorë nuk ishte Imzot Kaçorri, por edhe Luigi Gurakuqi, që të dy përfaqësues të bashkësisë katolike??? Dhe një përgjigje e mora ditën e riatdhesimit të eshtrave të Imzot Kaçorrit në Shqipëri, ku






Foto 1: Lista e delegatëve të asamblesë kombëtare të mbledhur për të shpallur pavarësinë, 28 nëndor 1912, në telegramin që konsulli Lejhanec i ka dërguar Vjenës zyrtare.
Foto 2: Veli Efendia përfaqësues i Gjirokastrës propozon Imzot Nikollë Kaçorrin për nënkryetar të qeverisë së parë dhe kraht të djathtë të Ismail Qemalit në informacionin e konsullatës austriake
Foto 3: Telegrami që konsullata austriake në Vlorë i dërgon ministrisë së jashtme të Austrisë për ta njoftuar për formimin e qeverisë së parë shqiptare
Foto 4: Telegram i konsullit austriak që raporton krijimin e senatit të parë shqiptar
Foto 5: Bashkangjitur telegramit: Emrat e përfaqësuesve nga krahinat e ndryshme të angazhuar në detyra të rëndësishme si dhe ruajtja e raporteve fetare me të zgjedhurit

andej, ishte një votë kombëtare rreth së cilës çdo zemër shqiptari mbyshje me afsh atdhetarie e mund të shfrentë lirisht.

Kurse në numrin 11 të po kësaj reviste të njohur, të nëntorit 1938-të, në faqen 610, autori i këtij shkrimi Shpend Bardha i cudituh dhe i indinjuar njëkohësisht vijon:

N'u zgjata pak veçantë përmbi këtë idealist të madh, e bana vec pse deri sod s'më ka ramë me këndue kund nonji rresht qi t'a përmendë sado për zgrip emnin e tij, me gjithë qi ka qenë, për kraht Ismail Kemal Vlorës, edhe ndënkryetar i denjë i së parës qeverie shqiptare, i zgjedhuh prej një atij Kuvendit Kombëtar qi shpalli pavarësinë e Atdheut e qi mund të krahasohet, për randsin e tij historike, vetëm me Kuvendin e Lezhës të kryesuem prej Fatosit të Kombit këtu e gati nja pesë shekuj përpara.....

Duke parë rolin që luajti Imzot Kaçorri në organizimin e lëvizjeve të armatosura në malsitë e Krujës e Kurbinit, që detyruan Stambollin të pranonte realitetin e ri shqiptar, mund të thuhet me siguri, që kontributi i Ismail Qemalit në diplomaci dhe i Imzot Kaçorrit në organizimin e kryengritjeve antiosmane, sollën pavarësinë e Shqipërisë, të shumëpritur në shekuj. Mbasi njëjthe mirë punën e Imzot Kaçorrit për pavarësimin e vendit, përfaqësuesi i Gjirokastrës në asamblenë kombëtare, Veli Efendia, e propozoj atë të jetë zëvendësi dhe krahu i djathtë i Kryeministrit të parë shqiptar Ismail Qemalit.

Ditët e sotme nga shteti po bëhen përjekje, shumë të debatuar nga masat e gjëra të popullit, familjarët, shtypi dhe historianët, për rrvarrorjen e eshrave të Isa Boletinit pranë Ismail Qemalit në Vlorë, por nuk kam dëgjuar (ndoshta është përsëri jashtë interesit të shtetit) të njëjtën gjë për heronjtë e kombit Imzot Nikollë Kaçorrin e Luigj Gurakuqin. Uroj dhe shpresoj që vendi ku gjendet varri i Imzot Kaçorrit në Durrës, të jetë po ashtu (si në Vlorë) një vend pelegrinazhesh për të gjithë rininë dhe çdo shqiptar patriot, në shenjë respekti dhe falenderimi për sakrificën e vetëmohimin e tij, për një Shqipëri të pavarur, të lirë nga errësira qindra vjeçare e pushtimit, Shqipërinë që gëzojmë në sot. Shpresoj që shteti e politika, do të kujtohen që të bëjnë një ndalesë në Durrës, për të vendosur një kurorë nderimi mbi varrin e atdhetarit Nikollë Kaçorri!

Po ashtu uroj dhe shpresoj që do të rindërtohet nga shteti, shtëpia e shembur e liberatorit Luigj Gurakuqi në Shkodër, që shteti të marrë në mbrojtje edhe reliket e tija (teshat e gjakosura e të shpuara nga plumbat) që po shkatërrohen të mbyllura në terrin, plururin dhe mykun e muzet të Shkodrës.

Bashkangjitur me këtë shkrim, për herë të parë po botoj një fotografi të arkitektit të pavarësisë Imzot Nikollë Kaçorrit, i cili është fotografuar nga miqtë e tij, pjesëtarët e familjes Marubi, fotografi që sot është pjesë e fototekës Marubi në Shkodër.

Wien, me 22.5.2015

përveç popullit të thjeshtë pa dalim feje apo ideje, në Rinas nuk priste asnjë autoritet nga politika apo administrata e shtetit, megjithëse i kisha informuar.

Shumë personalitete të huaja dhe shqiptare janë shprehur për ndihmesën, kulturën, karakterin dhe atdhetarizmin e Imzot Kaçorrit. Ndër personat që pat kontakte të shumta e që e njohu nga afër atë, ishte dhe Mustafa Merlika Kruja. Në numrin 9 të revistës Hylli i Dritës të vjetit 1938, në shkrimin: ... "Shqiptari" i 1912-tës.

Shqiptarizma në qarkun e Durrësit". .., autori Shpend Bardhi (pseudonim i Mustafa Merlika Krujës) mbasi përshkruen realitetin e situatës të ndezur në Durrës, i dedikon Imzot Nikollë Kaçorrit

këto fjalë.....Mu në ballë të shqiptarve të Durrësit, zjarrm e flakë për idealin kombëtar, shohim Dom Nikollë Kaçorrin. Përfaqësonte atje (në Durrës) kryepeshkopin e kryedioqezit të Durrësit, qi e kishte qendrën e vet në Delblinishtin e Kurbinit.

D. Nikolli ishte prej origjine malsorë; prej Lurës pitoreske atje nalt ndërmjet Matës, Dibrisë e Mirditës. Kishte lemë në një familje muslimane, mandej rritur e mësue në seminarin e Shkodrës. Shkonte e i shihte shpesh të vetët, e i donte shumë. Edhe ata e dojshin. Vllazni e dame ndër muslimane e katolike s'asht e vetmja në Lure ajo e Kaçorrëve. E ky ndryshim feje s'e cenon aspak dashurinë ndërmjet fiseve të një vllaznije. Këtë dashurinë ndërmjet muslimanve e të krishtenve,

D. Nikolli, prej familjes e kishte shtrime për vehte në të gjithë popullin shqiptar. E adhuronte kombin e vet, e i donte të gjithë shqiptarët, të njohun e të panjohun. Gjithashtu s'kishte njeri që t'a kishte njohun e mos t'a donte D. Nikollë Kaçorrin, natyrisht vec amiqve të shqiptarizëmës. Qela e tij në Durrës ishte një klub, qendra e atyne pak shqiptarve që numëroheshin n'atë qytet dhe vend vizitash, për të gjithë tjerët qi u takonte m'u pershku